



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Tiranë, më 23.01.2024

Vendim

Nr. 7 datë 23.1.2024

Për funksionimin e përkohshëm të Qendrës Kërkimore Shkencore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës pranë ASHSH (QKSHBGJ)

Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 59/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;

Në pajtim me nenin 45 të Statutit të ASHSH;

Me kërkesë të drejtuesve të kësaj qendre: akad. Genci Sulçebe, akad. emeritus Efigjeni Kongjika dhe akad. Ilia Mikerezi (bashkëngjitur),

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 23.1.2024:

Vendosi:

1. Qendra Kërkimore Shkencore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKSHBGJ), e themeluar me vendimin nr. 2 datë 10.1.2022 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, të vazhdojë të funksionojë si njësi e përkohshme deri në miratimin e projektvendimit paraqitur Këshillit të Ministrave nga ASHSH për shndërrimin e saj në qendër të përhershme.
2. QKSHBGJ të vazhdojë të veprojë në përputhje me dokumentet bazë të themelimit. Bordi drejtues të ketë të njëjtën përbërje të mëparshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: drejtuesit e tanishëm të QKSHBGJ, kryetari i SSHNT, sekretari shkencor dhe kancelari.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

